



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr.320, datë 19.12.2019

PËR
SKUALIFIKIMIN DHE PËRJASHTIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...} NGA
PROCEDURAT E EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 20.12.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatës znj. {...}përgatitur nga relatorja, znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatës znj. {...} nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës administrative”.

2. Me Vendimin nr.109, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës civile”.

3. Me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “*Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e të drejtës penale”.*

4. Brenda afatit të përcaktuar dyjavor nga dita e publikimit të vendimeve si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...} ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurat e konkurimit për pozicionet e lira të shpallura përmes vendimeve të mësipërme.

5. Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “*Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë*” (pika 1). Po me këtë vendim (pika 2 - 20), pas shortit të hedhur, për procedurën e verifikimit për kandidaten, znj. {...} është caktuar si relator znj.Marçela Shehu.

6. Më datë 26.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatja, znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua : - *për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit*; - *për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi*; - *për të të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit*, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

7. Brenda afatit treditore, kandidatja znj. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Më datë 26.07.2019, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion nuk ishte i plotë, kandidatja znj. {...}, në rrugë

elektronike, u njoftua për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

9. Po më datë 29.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidates znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidatja znj. {...}, depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, ndërsa brenda datës 06.09.2019 të caktuar me Vendimin nr. 142, datë 26.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datat 06.08.2019 dhe 07.08.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për znj. {...}.

12. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

13. Më datë 06.08.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit, asaj “*të pasjes gradë shkencore në drejtësi*”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), me Shkresën nr. 4163 prot., u kërkuar informacion dhe konfirmim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me fitimin e gradës shkencore në drejtësi nga kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ndër ta edhe për znj. {...}.

14. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka dërguar informacionin dhe konfirmimin përkatës, ndër të tjerë edhe për kandidatën znj. {...}, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4163/1 prot., datë 26.08.2019 (siç do të përshkruhet më poshtë).

15. Po më datë 06.08.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit “të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit të Statusit, por edhe të kriterit “të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe

disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”, përcaktuar në shkronjën “a”, pika 2, neni 49 në lidhje me shkronjë “dh” të nenit 28, të Ligjit të Statusit, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet shtetërore dhe private që kanë mbikqyrur disiplinën në punë të kandidatës znj. {...}, subjekte të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

16. Po në kuadër të verifikimit të kushtit dhe kriterit të kandidimit si më lart (sipas pikës 13), më datë 06.08.2019, u kërkua informacion në lidhje me punësimin e kandidatëve, ndër ta edhe për znj., nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

17. Në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit “të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit të Statusit, u kërkua informacion nga gjykata e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, sa i përket kandidatës znj. ka përcjellë informacionin e saj më datë 25.10.2019 (siç do të përshkruhet më poshtë).

18. Në vijim të verifikimit, në lidhje me kriterin e pasjes së zotësisë për të vepruar, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, më datë 24.10.2019, u kërkua informacion nga gjykata e vendbanimit të kandidatës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe nga Dhoma Kombëtare e Noterëve, të cilat kanë përcjellë informacion më datë 28.10.2019 dhe datë 30.10.2019 (siç do të përshkruhet më poshtë).

19. Në përfundim të procedurës së verifikimit, relatorja e çështjes, më datë 13.12.2019, ia ka parashtruar rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili, me vendimin e po kësaj date, ka vendosur: *“Kalimin për shqyrtim në Mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor të çështjes së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatës znj. {...}”*

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT SI GJYQTAR I GJYKATËS SË LARTË

1. Kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 136, pikat 3 dhe 4. Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, *“3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në”*

drejtësi. 4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj”.

2. Po ashtu, kushtet e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, janë përcaktuar edhe në Ligjin e Statusit, nenin 49 (“Emërimi i kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë”), pikat 1 dhe 2, shkronja “b”. Sipas rregullimeve në këto pika të kësaj dispozite, “1. Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. 2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: ...; b) të mos kenë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose në pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

3. Konkretisht, për kandidaten {...}ju verifikuan këto kushte kandidimi/emërimi:

a) qenia jurist.

a.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar (të njësuar me origjinalin) dokumentin Diplomë nr. 3051, me nr. regjistri 1974, lëshuar më datë 28.09.1993, nga Univerisiteti i Tiranës, sipas të cilit kandidatja {...}, në periudhën 1989 - 1993, ka kryer kursin e plotë të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në Degën “Drejtësi” dhe me vendim të Komisionit Shtetëror të datës 28.09.1993 i është dhënë titulli “Jurist”. Bashkëngjitur Diplomës është dhe dokumenti (i njësuar me origjinalin) “Lista e Rezultateve të Provimeve”, lëshuar më datë 10.07.1993, nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë;

b) përvoja profesionale prej jo më pak se 15 vjet, si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

b.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentacion, sipas të cilit kandidatja ka përvojë profesionale si vijon:

për periudhën 01.10.1993 - 01.10.1996 - pedagoge pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Shkodrës;

për periudhën 15.09.1996 - 07.01.1998 - Përgjegjëse e Sektorit Ligjor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;

për periudhën 07.01.1998 - 10.02.1999 - specialiste në Drejtorinë e Kodifikimit pranë Ministrisë së Drejtësisë;

për periudhën 10.02.1999 - Prill 2000 - Drejtore e Zyrës së Botimeve dhe Redaksisë së Revistës Drejtësia pranë Ministrisë së Drejtësisë;

për periudhën Maj 2000 - 27.09.2007 - Drejtore e Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

për periudhën 10.10.2013 - 17.05.2018 - Drejtore e Qendrës së Botimeve Zyrtare.

b.2 Gjatë verifikimit, referuar subjekteve ku kandidatja figuronte të kishte qenë e punësuar sipas dokumentacionit të paraqitur, prej tyre u kërkua informacion për të dhënat e punësimit të kandidates. Konkretisht :

me Shkresën nr. 2753/1 prot., datë 22.08.2019, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” informon se kandidatja: *“ka punuar pedagoge dhe drejtore e Departamentit Juridik pranë Fakultetit të Drejtësisë në periudhën 01.10.1993 - 01.10.1996 dhe nuk ka patur asnjë masë disiplinore ndaj saj”;*

me Shkresën nr. 5885/1 prot., datë 16.08.2019, Ministria e Drejtësisë informon se kandidatja: *“ka punuar pranë Ministrisë së Drejtësisë në pozicionet dhe periudhat sa më poshtë: - nga data 07.01.1998 - 10.02.1999, në detyrën specialiste në Drejtorinë e Kodifikimit; - më datë 10.02.1999 është emëruar Drejtore e Zyrës së Botimeve dhe Redaksisë “Revista Drejtësia. ... nga verifikimi i regjitrave të personelit dhe dokumenteve në Sektorin e Arkiv-Protokollit, për znj. {...}*

, rezultojnë masat disiplinore si më poshtë: - me Urdhër të Drejtorisë së Personel-Organizimit dhe Shërbimeve nr. 162 datë 04.09.2000 i është dhënë masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” në pozicionin Drejtore e Qendrës së Publikimeve Zyrtare; - me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 2779/7, datë 27.09.2007, i është dhënë masë disiplinore "Largim nga shërbimi civil" nga pozicioni Drejtore e Qendrës së Publikimeve Zyrtare; - me Vendim të Komisionit Disiplinor nr.2658/10, datë 16.05.2018, i është dhënë masë disiplinore "Largim nga shërbimi civil" nga pozicioni Drejtore e Qendrës së Botimeve Zyrtare”;

me shkresën nr. 8874/1, datë 25.11.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, informon se: *“zgj. ka qenë në detyrë Përgjegjëse e Sektorit Ligjor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve nga viti 1996 deri në vitin 1998. Gjatë kësaj periudhe, zgj. ka patur një kontribut të ndjeshëm në hartimin e akteve ligjore bazë të sistemit të burgjeve, të cilat janë miratuar në prill 1998. ...”;*

me Shkresën nr. 967/2 prot., datë 12.09.2019, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë informon se kandidatja: *“ka punuar pedagoge e jashtme e Departamentit të së Drejtës Publike pranë Fakultetit të Drejtësisë në vitin akademik 2007 - 2008 dhe nuk ka patur asnjë masë disiplinore ndaj saj”;*

me Shkresën nr. 177 prot., datë 07.08.2019, Kolegji Universitar “Qiriazi” informon se kandidatja: *“është e punësuar si shefe e Departamentit të së Drejtës Civile dhe lektore e së drejtës tregtare e procedurës civile.... Ndaj saj nuk ka patur asnjëherë masë disiplinore ...”;*

me Shkresën nr. 378/1 prot., datë 13.08.2019, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë informon se kandidatja: *“Subjekti av. {...}mbajtës i licensës nr. 686 është anëtare e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe ushtron profesionin e avokates pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë prej vitit*

2009 - 2013, 2018 e në vazhdim; Subjekti {...}ka shlyer detyrimet financiare dhe në ngarkim të saj nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore në proces”;

me Shkresën nr. 9/1 prot., datë 29.10.2019, Fondacioni “Hafiz Ali Korça”, i cili administron Kolegjin Universitar “Bedër”, informon se kandidatja: “ka qenë e punësuar në periudhën 09.03.2019 - 30.06.2019, me kohë të pjesshme, lektore pranë Departamentit të Drejtësisë, në kolegjin Universitar “Bedër” ... dhe ka përmbushur të gjitha detyrimet e kontratës dhe ka respektuar rregullat e institucionit”;

me Shkresën nr. 14659/1 prot., datë 04.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve informon se kandidatja: “ka qenë e punësuar në periudhën 25.03.2019 - 30.06.2019, me kohë të pjesshme, si specialist jurist në Drejtorinë Juridike ...”.

b.3 Po ashtu, gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Konkretisht:

me Shkresën nr. 15071/1 prot., datë 13.08.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ndër të tjera, informon se : “...3. Për shtetasen {...}

), nuk rezulton e regjistruar në organin tatimor me aktivitet privat ... për efekt burim të ardhura nga paga, rezulton të ketë punuar ose/dhe punon pranë subjektit: 1. Qendra e Botimeve Zyrtare - Titullare Institucioni 2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - Nëpunëse elektorale (zgjedhjesh) 3. Sevasti & Parashqevi Qirjazi - Pedagoge 4. Alb Juris - Avokate 5. Fondacioni “Hafiz Ali Korça” - Pedagoge”.

me Shkresën nr. 5744/1 prot., datë 09.08.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore informon për të dhëna punësimi të kandidatit për periudhën janar 2012 e në vijim, referuar të dhënave të nxjerra nga sistemi informatik i saj, që dispononte të dhëna për kontributet që mblidheshin dhe dërgoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet WebService, të dhëna këto që disponoheshin nga viti 2012 dhe në vijim. Sipas të dhënave të dërguara përmes kësaj shkrese, jepen të njëjta të dhëna punësimi të kandidatës sikundër ato të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si më lart;

me Shkresën nr. 8468 prot., datë 17.09.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, informon për të dhënat e punësimit të kandidatës për periudhën 1994¹ - 2012, si vijon: e punësuar pranë Ministrisë së Drejtësisë për periudhën Janar 1998 - Prill 2000; e punësuar pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare për periudhën Maj 2000 - Dhjetor 2003, Janar 2004 - Dhjetor 2007, Janar 2008 - Dhjetor 2011, Janar - Dhjetor 2012;

me Shkresën nr. 5783/1 prot., datë 29.10.2019, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Dega e Arkivit të Rajonit Shkodër, informon për të dhënat e punësimit të kandidatës pranë

¹ Koha kur ka filluar zbatimi i Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” sipas të cilit, për përfitimin e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore, organet e sigurimeve shoqërore grumbullonin dokumentacionin për veprimtaritë ekonomike të të punësuarve dhe mblidhnin kontributet e paguara të sigurimeve shoqërore.

Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër për periudhën Korrik 1994 - Gusht 1995, Korrik 1996 - Shtator 1996.

b.4 Sipas të dhënave të grumbulluara, kandidatja {...}del të ketë përvojë profesionale, me kohë të plotë, deri në momentin e kandidimit, si vijon: juriste e nivelit të lartë në administratën publike rreth 14 vjet e 5 muaj; pedagogë mbi 3 vjet. Në total, kandidatja ka përvojë profesionale, me kohë të plotë, si lektore e të drejtës dhe si juriste e nivelit të lartë në administratën publike përmbi 17 vjet.

c) pasja gradë shkencore në drejtësi.

c.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidati ka depozituar dokumentat:

Diplomë Doktorate nr. 11433 Regjistri, lëshuar me datë 30.10.2015 nga Universiteti Romës “La Sapienza” Itali, sipas të cilit kandidatja {...}, ka marrë titullin “doktor”;

Vërtetim nr. 7740/1 prot. datë 01.08.2016, lëshuar nga Ministria e Arsimit sipas të cilit bazuar në vendimin nr. 252 datë 30.04.2014 të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë” pika 2, gërma b, si dhe vendimit nr. 52 datë 26.07.2016 të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, Grada Shkencore “Doktor” në “Drejtësi” fituar me datë 30.10.2015 nga Universiteti Romës “La Sapienza” Itali nga znj. {...}është e barasvlefshme me gradën shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë.

c.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila, me Shkresën nr. 7834/1 prot., datë 23.08.2019, informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se: “...3. Grada shkencore “Doktor” në “Drejtësi” e fituar nga znj. {...}në Universitetin “La Sapienza” Romë, Itali, rezulton të jetë njohur në Republikën e Shqipërisë dhe figuron e regjistruar në regjistrin themeltar për Gradën Shkencore dhe titujt akademikë të mbrojtur jashtë vendit me numër rendor: 407 ... / Të gjitha gradat shkencore të listuara më sipër, përveç gradës shkencore të fituar nga ..., i përkasin fushës së drejtësisë”.

ç) mbajtja e funksioneve politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

ç.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 30.07.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se “nuk kam mbajtur funksione politike në administratën publike, ..., gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”.

ç.2 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi/emërimi u morën dhe vlejën të dhënat e informacioneve sipas pikës b), Kreu II, të këtij relacioni. Nga informacionet e marra nuk

identifikohet ndonjë e dhënë sipas të cilës të verifikohet që kandidatja të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

d) mbajtja e pozicioneve drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit.

d.1 Për këtë kusht kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim të datës 30.07.2019, nëpërmjet të cilës përkundrejt përgjegjësisë ligjore ka deklaruar se *“nuk kam mbajtur ... pozicione drejtuese në parti politike, gjatë dhjetë viteve të fundit para kandidimit”*.

d.2 Gjatë verifikimit, për këtë kusht kandidimi u kërkua dhe u mor informacion nga gjykata e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me Shkresën nr. 84-7/4 prot., datë 28.10.2019, sa i përket kandidatës {...}ka informuar se *“Nga verifikimet e kryera në aktet e depozituara nga subjektet politike, në regjistrin e Partive Politike pranë kësaj gjykate nuk rezulton që shtetasit ... {...}... të kenë qenë pjesë e organeve drejtuese të Partive Politike”*.

4. Nga sa rezulton, kandidatja znj. plotëson kushtet e kandidimit/emërimit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të përcaktuara në nenin 136, pikat 3 dhe 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të Ligjit të Statusit.

III. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDIMIT/EMËRIMIT SI GJYQTAR I GJYKATËS SË LARTË

A. Për kriteret sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit

1. Disa nga kriteret e kandidimit/emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, përcaktohen në Ligjin e Statusit, neni 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”.

1.1 Sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a”, të Ligjit të Statusit, *“2. Kandidatët jogjyqtarë për pozicione në Gjykatën e Lartë duhet: a) të plotësojnë kriteret e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "ë" dhe "f", të nenit 28, të këtij ligji; ...”*.

1.2 Ndërsa sipas nenit 28, shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “ë” dhe “f”, të Ligjit të Statusit, që parashikon kriteret e pranimit në formimin fillestar dhe bën pjesë në institutin e rekrutimit të kandidatëve magjistratë, *“Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; ...; d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë; dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; ...; ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi*

i Shtetit përpara vitit 1990; f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.

2. Konkretisht, për kandidaten {...} u verifikuan këto kritere kandidimi/emërimi:

a) zotësia e plotë për të vepruar.

a.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi u mbajt në konsideratë se “zotësia për të vepruar”, si kategori juridike që i takon individit, gjen rregullim në legjislacionin civil (Kodin Civil), ndërsa i njëjti kuptim për të konsiderohet edhe kur individ është subjekt i të drejtës publike. Zotësia për të vepruar nënkupton aftësinë e personit për të qenë bartës i të drejtave dhe detyrimeve. Zotësia për të vepruar fitohet me arritjen e moshës 18 vjeç dhe, sipas ligjit, pasja e kësaj zotësie prezumohet deri në vërtetimin e heqjes apo kufizimit të saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

a.2 Nisur nga kuptimi i nocionit të “zotësisë për të vepruar”, referuar moshës së kandidates, ajo del ta ketë fituar këtë zotësi, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë. Me Shkresën nr. 8407/2 prot., datë 25.10.2019 gjykata e vendbanimit të kandidates, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, informon se nga verifikimet e bëra nuk rezulton të jetë paraqitur kërkesë për heqjen e zotësisë për të vepruar për kandidaten {...}Ndërsa me Shkresën nr. 2659 prot., datë 30.10.2019, Dhoma Kombëtare e Noterisë, informon se nga verifikimi i bërë i listës së personave të cilëve iu është hequr zotësia për të vepruar, rezulton se kandidatja z. nuk figuron në atë listë.

a.3 Nisur nga kuptimi i nocionit të “zotësisë për të vepruar”, referuar moshës së kandidates, ajo del ta ketë fituar këtë zotësi, ndërsa prezumohet ta ketë atë përderisa gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) shtetësia shqiptare.

b.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentin “Letërnjoftim”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 10.02.2009, ku pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, konkretisht “shqiptare”.

b.2 Gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidatë. Përkundrazi, nga çertifikata familjare lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, më datë 23.05.2017 (dorëzuar nga vetë kandidatja) si dhe çertifikata personale lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, më datë 22.11.2019, konstatohet se kandidatja vijon të ketë shtetësinë shqiptare.

c) gjendja gjyqësore.

c.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar dokumentin “Vërtetim i gjendjes gjyqësore”, me nr. 11 prot., datë 30.07.2019, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sipas të cilit kandidatja figuron e padënuar penalisht.

c.2 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore), e cila, me Shkresën nr. V-2595/1 prot., datë 09.08.2019, ndër të tjera, informon se nga verifikimi i bërë në Regjistrin Themeltar të Gjendjes Gjyqësore, kandidatja rezulton e padënuar nga gjykatat penale shqiptare.

ç) disiplina në punë.

ç.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 30.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se *“gjatë karrierës time profesionale nuk jam larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk kam marrë dhe as nuk kam asnjë masë disiplinore”*.

ç.2 Gjithashtu, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar ndër të tjera një Vërtetim nr. 153 prot. datë 08.03.2017, lëshuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë me të cilin vërtetohet se kandidatja është mbajtëse e licensës nr. 686 si anëtare e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe ushtron profesionin e avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë prej vitit 2009 - 2013 *....nuk ka detyrime financiare dhe në ngarkim të saj nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore në proces”*.

ç.3 Gjatë verifikimit, u kërkua dhe u mor informacion nga subjektet shtetërore dhe privatë, ku kandidatja ka punuar dhe punon aktualisht.

me Shkresën nr. 2753/1 prot., datë 22.08.2019, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, informon se kandidatja: *“ka punuar pedagoge dhe drejtore e Departamentit Juridik pranë Fakultetit të Drejtësisë në periudhën 01.10.1993 - 01.10.1996 dhe nuk ka patur asnjë masë disiplinore ndaj saj”*;

me shkresën nr. 8874/1, datë 25.11.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, informon se: *“znj. ka qenë në detyrë Përgjegjëse e Sektorit Ligjor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve nga viti 1996 deri në vitin 1998. Gjatë kësaj periudhe, znj. ka patur një kontribut të ndjeshëm në hartimin e akteve ligjore bazë të sistemit të burgjeve, të cilat janë miratuar në prill 1998. ...”*;

me Shkresën nr. 5885/1 prot., datë 16.08.2019, Ministria e Drejtësisë informon se kandidatja: *“ka punuar pranë Ministrisë së Drejtësisë në pozicionet dhe periudhat sa më poshtë: - nga data 07.01.1998 - 10.02.1999, në detyrën specialiste në Drejtorinë e Kodifikimit; - më datë 10.02.1999 është emëruar Drejtore e Zyrës së Botimeve dhe Redaksisë “Revista Drejtësia. ... nga verifikimi i regjitrave të personelit dhe dokumenteve në Sektorin e Arkiv-Protokollit, për znj. {...}, rezultojnë masat disiplinore si më poshtë:*

me Urdhër të Drejtorisë së Personel-Organizimit dhe Shërbimeve nr. 162 datë 04.09.2000 *i është dhënë masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” në pozicionin Drejtore e Qendrës së Publikimeve Zyrtare;*

me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 2779/7, datë 27.09.2007, *i është dhënë masë disiplinore “Largim nga shërbimi civil” nga pozicioni Drejtore e Qendrës së Publikimeve Zyrtare;*

me Vendim të Komisionit Disiplinor nr.2658/10, datë 16.05.2018, *i është dhënë masë disiplinore “Largim nga shërbimi civil” nga pozicioni Drejtore e Qendrës së Botimeve Zyrtare”;*

me Shkresën nr. 967/2 prot., datë 12.09.2019, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë informon se kandidatja: *“ka punuar pedagoge e jashtme e Departamentit të së Drejtës Publike pranë Fakultetit të Drejtësisë në vitin akademik 2007 - 2008 dhe nuk ka patur asnjë masë disiplinore ndaj saj”;*

me Shkresën nr. 177 prot., datë 07.08.2019, Kolegji Universitar “Qiriazi” informon se kandidatja: *“është e punësuar si shefe e Departamentit të së Drejtës Civile dhe lektore e së drejtës tregtare e procedurës civile.... Ndaj saj nuk ka patur asnjëherë masë disiplinore ...”;*

me Shkresën nr. 378/1 prot., datë 13.08.2019, Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë informon se kandidatja: *“Subjekti av. {...}) mbajtës i licensës nr. 686 është anëtare e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe ushtron profesionin e avokates pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë prej vitit 2009 - 2013, 2018 e në vazhdim; Subjekti ka shlyer detyrimet financiare dhe në ngarkim të saj nuk figurojnë masa apo procedime disiplinore në proces”;*

me Shkresën nr. 9/1 prot., datë 29.10.2019, Fondacioni “Hafiz Ali Korça” i cili administron Kolegjin Universitar “Bedër” informon se kandidatja: *“ka qenë e punësuar në periudhën 09.03.2019 – 30.06.2019 me kohë të pjesshme, lektore pranë Departamentit të Drejtësisë, në kolegjin Universitar “Bedër” ... dhe ka përmbushur të gjitha detyrimet e kontratës dhe ka respektuar rregullat e institucionit”;*

me Shkresën nr. 14659/1 prot., datë 04.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve informon se kandidatja: *“ka qenë e punësuar në periudhën 25.03.2019 - 30.06.2019 me kohë të pjesshme, si specialist jurist në Drejtorinë Juridike ... ”. Nga kjo shkresë nuk rezulton që ndaj saj të jenë marrë masa disiplinore.*

ç.4 Nga të dhënat e grumbulluara gjatë procedurës së verifikimit në lidhje me disiplinën në punë të kandidatës, u identifikuan të dhëna që tregojnë se kandidatja në dy raste është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, të dhëna këto që në raport me plotësimin e këtij kriteri ligjor të kandidimit do të trajtohen më hollësisht në vijim të këtij vendimi.

d) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990.

d.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 30.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjesisë ligjore, ka deklaruar se “nuk kam qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990”.

d.2 Gjatë verifikimit, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 30.07.2019, kandidatja dorëzoi të plotësuar formularin e aplikimit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

d.3 Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 1177/4 prot., datë 12.09.2019, Vendimin nr. 565 datë 10.09.2019, me të cilin është vendosur: “Të informojë institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 4228 prot., datë 27.08.2019, “Kërkesë për verifikim”, të pastërtisë së figurës, përpara emërimit të kandidatit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur, se nga verifikimet e kryera deri tani për znj. nuk rezultoi: a) të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas përcaktimeve të nenit 29 të Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

dh) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

dh.1 Për këtë kriter kandidimi/emërimi, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 30.07.2019, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjesisë ligjore, ka deklaruar se “nuk kam qenë dhe nuk jam bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete”.

dh.2 Gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit edhe të kriterit të figurës së kandidates, u kërkua dhe u mor informacion nga shërbimet shtetërore informative, nga të cilat nuk u bë prezent ndonjë e dhënë për qenien e kandidates, bashkëpunëtoresh, informatore, ose agjente të shërbimeve sekrete.

B. Për kriterin e pasurisë sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit

1. Për kandidaten u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49² në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32³, të Ligjit të Statusit.

² “5. Këshilli vlerëson përmbushjen e kriterëve, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, dhe verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. Kandidatët, të cilët nuk përmbushin kriteret ose nuk kalojnë procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, përjashtohen nga kandidimi”.

³ “2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten , u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 107/25 prot., datë 10.10.2019.

3. Pas njohjes së kandidates me këtë Raport dhe paraqitjes nga ajo të sqarimeve dhe dokumentacionin mbështetës, u kërkua raportim shtesë nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin Shtesë të datës 31.10.2019.

3. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të cilat kanë paraqitur pranë Këshillit informacionin përkatës.

C. Për kriterin e figurës sipas nenit 49, pika 5, të Ligjit të Statusit

1. Për kandidaten u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten , u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

3. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten , asaj iu kërkua dhe ajo plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 30.07.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në

dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...”.

zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin.

IV. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI I REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi u njoh me relacionin përkatës të relatores së çështjes, si dhe materialet e grumbulluara gjatë verifikimit, marrë shkas nga problematika e ngritur nga relatorja e çështjes në lidhje me një nga kriteret e kandidimit të znj. , me vendim të ndërmjetëm, për racionalitet dhe efektivitet, vendosi të shqyrtonte paraprakisht rezultatet e verifikimit vetëm sa i përkiste kushteve dhe kriterëve formale të kandidimit dhe, në varësi të kësaj, nëse konkludohej për përmbushjen e tyre nga kandidatja, të vijonte shqyrtimi edhe për kriteret e pasurisë dhe të figurës.

2. Në lidhje me kushtet dhe kriteret formale të kandidimit të znj. , pas shqyrtimit të rezultateve të verifikimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja përmbush ato, me përjashtim të një prej kriterëve të kandidimit.

3. Konkretisht, gjatë procedurës së verifikimit është konstatuar si gjetje, që mund të passillte skualifikimin dhe përjashtimin e kandidates nga procedurat e emërimit ku ajo ka kandiduar, mosplotësimi nga ajo të kriterit të disiplinës në punë, pikërisht **“nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”**, përcaktuar në nenin 28, gërma “dh”, të Ligjit për Statusin. Të dhënat konkrete të kandidates në lidhje me këtë kriter janë evidentuar në shkronjën “ç”, Kreu III, të këtij Vendimi.

4. Gjatë procedurës së verifikimit, marrë shkas nga informacioni i dërguar nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me masat disiplinore “largim nga shërbimi civil” të dhëna me Vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, nr. 2779/7 datë 27.09.2007 dhe me Vendim të Komisionit Disiplinor pranë Ministrisë së Drejtësisë nr.2658/10 datë 16.05.2018, kandidates znj., më datë 25.10.2019, në përputhje me Vendimin 75/2019, iu njoftuan të dhënat sipas informacionit të Ministrisë së Drejtësisë, duke u ftuar ajo për të paraqitur shpjegime apo edhe çdo dokumentacion mbështetës që do të vlerësonte të nevojshëm.

5. Më datë 28.10.2019, kandidatja znj. depozitoi në rrugë elektronike pretendimet e saj në lidhje me masat disiplinore “Largim nga shërbimi civil” të dhëna për të, duke parashtruar si më poshtë:

“Në përgjigje të kërkesës më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj faktin se:

Kam filluar punë në Qendrën e Publikimeve Zyrtare në muajin shkurt të vitit 1999 në pozicionin e Drejtores.

Me vendimin nr.2779/7, datë 27.9.2007, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë jam liruar nga shërbimi civil.

Kundër këtij vendimi jam ankuar pranë Komisionit të Shërbimit Civil (KSHC), i cili me vendimin nr. 46, datë 12.02.2008 ka vendosur: "...Pranimin e ankesës së Znj. ; shfuqizimin e aktit nr. 2779/7, dt.27.09.2007 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, si në kundërshtim me procedurën e caktuar nga ligji; rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës dhe kryerjen e pagesës për ankuesen nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare e deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi..."

Kundër këtij vendimi, Ministria e Drejtësisë ka paraqitur padi pranë Gjykatës së Apelit Tiranë me objekt: "Kundërshtimin e vendimit nr. 46, datë 12.02.2008 të KSHC."

Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 94, datë 14.07.2008, vendosi: "Rrëzimin e kërkesë padisë së Ministrisë të Drejtësisë duke lënë në fuqi vendimin e KSHC."

Kundra këtij vendimi ka paraqitur rekurs Ministria e Drejtësisë në Gjykatën e Lartë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 170, datë 26.02.2010 ka vendosur: "...Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë kundër vendimit nr.94, dt.14.07.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë..."

Me vendimin nr. 136, datë 18.12.2008, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi: "Lëshimin e urdhrorit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv vendimin nr. 94, datë 14.07.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë."

Zyra e Shërbimit Përmbartimor pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. 430, datë 13.01.2009, ka lajmëruar Ministrinë e Drejtësisë për ekzekutimin vullnetar dhe me shkresën nr. 3275, datë 09.03.2009 ka marrë vendim për kalimin në ekzekutim të detyruar.

Ky vendim nuk u ekzekutua nga Ministria e Drejtësisë, dhe në këto kushte iu drejtova Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për "Konstatimin e cënimit të parimit për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)."

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 1.2.2011, ka vendosur: "Konstatimin e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNj-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm".

Bashkëlidhur po ju dërgoj provat e kërkuara nga ana juaj, për sa parashtroni në kërkesë."

Ndërsa lidhur me masën disiplinore të dhënë me vendimin e Komisionit Disiplinor nr.2658/10 datë 16.05.2018, kandidatja shprehet se ky vendim është kundërshtuar në rrugë gjyqësore dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2641 datë 09.07.2018, ka vendosur pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr. 2658/10 datë 16.05.2018 të Komisionit të Disiplinës pranë Ministrisë së Drejtësisë. Ndaj vendimit është ushtruar ankim nga pala e paditur, Ministria e Drejtësisë dhe çështja është dërguar për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë".

6. Duke marrë shkas nga pretendimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga kandidatja, në funksion të verifikimit të fakteve të parashtruara prej saj në lidhje me masën e detyrë të largimit nga shërbimi civil, më datë 29.10.2019, nga relatorja e çështjes është kërkuar informacion nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit.

6.1 Me Shkresën nr. 10174/1 prot., datë 30.10.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë informon se: *“lidhur me sa ka kërkuar Këshilli mbi gjykimin e padisë së kandidates , kjo gjykatë me vendimin nr. 2641, datë 09.07.2018, ka vendosur: “Pranimin e padisë. Shfuqizimin e vendimit nr. 2658/10 datë 16.05.2018 të Komisionit të Disiplinës pra në Ministrinë e Drejtësisë ...”.* Ndaj vendimit është ushtruar ankimi dhe çështja është dërguar për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ku ende ndodhet deri më datë 29.10.2019.”

6.2. Me Shkresën nr. 329 prot., datë 29.10.2019, Gjykata Administrative e Apelit informon se çështja si më lart është regjistruar në këtë gjykatë më datë 10.09.2018 dhe është planifikuar për gjykim, në dhomë këshillimi, më datë 14.11.2019 ora 10.20.

7. Në vijim të komunikimeve verifikuese të relatores së çështjes sa i përkiste gjykimin të kësaj çështje, ka rezultuar se ajo nuk është shqyrtuar në ditën e planifikuar (më datë 14.11.2019), pasi dy gjyqtarë nga trupa gjykuese kishin dhënë dorëheqjen. Më pas, më datë 19.12.2019, kandidatja, ka dërguar në rrugë elektronike, dispozitivin e vendimit të dhënë në këtë datë nga Gjykata Administrative e Apelit, sipas të cilit është vendosur lënia në fuqi të Vendimit nr.2641, datë 09.07.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Një fakt i tillë është verifikuar nga relatorja e çështjes, ndërsa pjesa urdhëruese e vendimit pasqyrohet në website-in e Gjykatës Administrative të Apelit.

8. Nisur nga sa rezulton në lidhje me këtë kriter kandidimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi, të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, vlerëson se kandidatja znj. {...} duhet të skualifikohet dhe përjashtohet nga procedurat e emërimit për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë ku ka kandiduar pikërisht për shkak të mosplotësimit të këtij kriteri ligjor kandidimi. Në këtë konkluzion Këshilli arrin në vlerësim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, frymës dhe qëllimit të ligjbërësit në lidhje me përzgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

9. Nga interpretimi i dispozitave kushtetuese dhe ligjore të posaçme, *lex specialis*, rezulton se ligji material ka përçarur qëllimin e kushtetutbërësit për transformimin e Gjykatës së Lartë *“në një gjykatë karriere përmes vendosjes së kritereve transparente për emërimin e gjyqtarëve nga të dy kategoritë (gjyqtar dhe jogjyqtar/juristë të spikatur)”* për të garantuar një përbërje cilësore, jo vetëm nga pikëpamja profesionale, por në veçanti edhe sa i përket integritetit dhe figurës. Përmes vendosjes së kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë synohet identifikimi dhe përzgjedhja e profesionisteve në fushën e drejtësisë, të cilët të kenë aftësi të

spikatura sipas kategorive të saj, për njëherazi edhe një integritet të lartë moral, sepse suksesi i vërtetë i çdo gjykate, në veçanti i Gjykatës së Lartë, si organi më i lartë i pushtetit gjyqësor, varet nga kompetenca profesionale dhe integriteti moral i çdo gjyqtari, si ushtrues të drejtpërdrejtë të pushtetit gjyqësor në funksion të dhënies së drejtësisë raste individuale dhe veçanërisht për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të ligjit me qëllim për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

10. Ligji i posaçëm, Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 28, shkronja “dh”, parashikon si kriter zgjedhshmërie, për pranimin në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe, më tej, për rekrutimin e gjyqtarit, mosqenien e kandidatit “*i larguar nga detyra për shkaqe disiplinore*”, si dhe “*mospasjen masë disiplinore në fuqi*”. Ky kriter zgjedhshmërie është konsideruar nga ligji i posaçëm, neni 49, pika 2, shkronja “a”, edhe për kandidatët për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

11. Duke ardhur në rastin konkret jemi para faktit që kandidates, znj. {...}, ndërsa ka qenë në ushtrim të funksionit si Drejtore e Qendrës së Botimeve Zyrtare pranë Ministrisë së Drejtësisë, me Vendim të Komisionit Disiplinor nr.2658/10, datë 16.05.2018, i është dhënë masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*” nga pozicioni Drejtore e Qendrës së Botimeve Zyrtare” pra, rezulton se kandidatja është shkarkuar/larguar nga detyra për shkaqe disiplinore.

12. Masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*” është kundërshtuar gjyqësisht nga kandidatja, por se padia gjyqësore e kandidates, sikundër edhe vendimi i ankimuar gjyqësisht i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që ka pranuar padinë, referuar Ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative (neni 104), Ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe Kodit të Procedurës Civile (neni 449), nuk pezullojnë efektet e vendimit të largimit nga shërbimi civil, pra, pavarësisht atyre, marrëdhënia e shërbimit civil në këtë rast konsiderohet nga ligji si e përfunduar pikërisht për shkak të largimit të kandidates nga shërbimi civil, si masë disiplinore (neni 63, shkronja “b”), situatë kjo që ka qenë e tillë edhe në momentin kur kandidatja znj. ka konkuruar për ato pozicione të lira të shpallura për në Gjykatën e Lartë. Pra, masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*” dhënë ndaj kandidates znj. më datë 16.05.2018, ka qenë në fuqi dhe ka prodhuar efekte sipas ligjit edhe në momentin kur ajo ka kandiduar për në Gjykatën e Lartë, respektivisht më datë 25.07.2019.

13. Fakti që një ditë përpara shqyrtimit të çështjes nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pra më datë 19.12.2019, masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*” e dhënë ndaj kandidates znj. është shfuqizuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në vlerësim të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk ka asnjë ndikim në përfundimin e tij si më lart, pra që kandidatja, në momentin e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, nuk ka plotësuar kriterin e disiplinës në punë, sipas nenit 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit të Statusit.

14. Vendimi gjyqësor i formës së prerë për shfuqizimin e vendimit të masës disiplinore, në rastin konkret "Largim nga shërbimi civil", dhënë në favor të kandidates znj., ligjërisht krijon efektet e veta juridike, ndër to edhe të rënies së kësaj mase disiplinore, vetëm për të ardhmen, pra për periudhën pas momentit të shpalljes së tij, ndërsa kandidatja, si nëpunëse civile, sipas ligjit për nëpunësin civil, gëzon të drejtën e rikthimit në detyrë dhe nëse kjo është objektivisht i pamundur, regjistrimin e saj në listë pritjeje deri në sistemimin në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, duke gëzuar gjatë kohës së qëndrimit në këtë listë të drejtën e pagës sipas pozicionit të fundit që ka patur në shërbimin civil (neni 66/1 i Ligjit nr.153/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar).

15. Thënë sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon se znj. në momentin e kandidimit për pozicionin e gjyqtarës në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ka pasur masë disiplinore në fuqi, pikërisht atë të "Largim nga shërbimi civil", që përbën kriter ndalues për kandidim për gjyqtar në Gjykatën e Lartë. Fakti se kjo masë disiplinore ka qenë e ankimuar në rrugë gjyqësore dhe në momentin e kandidimit ka patur një vendim gjyqësor të shkallës së parë, jo të formës së prerë në favor të kandidates, e më pas në momentin e shqyrtimit të çështjes nga Këshilli një vendim të formës së prerë po në favor të kandidates, ritheksohet se nuk mund të ndryshojnë rrethanën penguese ekzistuese të kandidimit, pra se në momentin e kandidimit znj. kishte një masë disiplinore në fuqi.

16. Këshilli i Lartë Gjyqësor në ushtrim të funksionit të propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, realizon procedurat e ngritjes në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë edhe për kandidatët nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarëve), duke u mbështetur në një sërë ligjesh, midis tyre dhe në Kodin e Procedurave Administrative. Gjatë procedurës administrative, në respektim të parashikimeve ligjore, Këshilli udhëhiqet nga disa parime, të cilësuar si të përgjithshme, të cilat vendosin disa standarte sesi duhet të sillet organi vendimmarrës gjatë një procedurë administrative.

17. Parimi bazë, që në fakt garanton mundësinë edhe për respektimin e parimeve të tjera, është ai që lidhet me procedurën e më konkretisht ai i "procesit të rregullt ligjor". Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor⁴. Gjykata Kushtetuese, në Vendimin nr.76, datë 26.04.2002, ndër të tjera, ka arsyetuar se: "...omissis... **çdo organ i pushtetit publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor është i detyruar të respektojë standartet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë**".

18. Ky parim është i lidhur ngushtë me parimin e "drejtësisë dhe paanësisë". Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me

⁴ Neni 4/2 i Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

të cilat krijon marrëdhënie⁵. Parimi i drejtësisë dhe paanësisë nënkupton që organi publik vendimmarrës duhet të marrë të gjitha masat që të eliminojë çdo mundësi apo rrethanë që rrezikon objektivitetin e vendimmarrësit, për t'i garantuar të gjitha palët që janë përfshirë në një marrëdhënie juridike me të se nuk do të mbajë anësi dhe do t'i trajtojë të gjithë me barazi. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga organi vendimmarrës për çështjet që shtrohen përpara tij⁶.

19. Përveç sa më sipër, Këshilli mban në konsideratë edhe parimin e barazisë⁷. Sipas këtij parimi, *“Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë”*, çka në rastin e procedurës konkrete përpara Këshillit ky parim nënkupton se kandidatët që kandidojnë për t'u bërë gjyqtar në organin më të lartë gjyqësor në Shqipëri duhet të vendosen në kushte të barabarta. Për t'u vendosur në kushte të barabarta, duhet që plotësimi i kushteve të kandidimit për kandidatët që marrin pjesë në këtë procedurë të vlerësohet në të njëjtin moment për të gjithë kandidatët. Momenti se kur do të duhet të konsiderohen të përmbushura kushtet e kandidimit lidhet pikërisht me momentin e aplikimit, pasi vetëm gjatë kësaj kohe (*e cila si rregull zgjat vetëm disa ditë*) kandidatët mund të vihen faktikisht nën të njëjtat kushte të barabarta. Gjithashtu, ky është edhe momenti që fillon marrëdhënia juridike administrative midis kandidatit dhe organit administrativ, që në këtë rast është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

20. Nëse do të pranohet të kundërtën, që kandidati të vlerësohet në lidhje me përmbushjen ose jo të kriterëve/kushteve të kandidimit në momentin e vlerësimit, ose të marrjes së vendimit nga ana e organit kompetent, kjo do t'i vendoste kandidatët mes tyre në kushte jo të njëjta, pra jo të barabarta. Kjo gjë mund të çojë në konfuzion të garës që zhvillohet, si midis vetë kandidatëve, ashtu edhe për publikun që është i interesuar gjatë kësaj procedure të rëndësishme. Nga ana tjetër, organi vendimmarrës nuk mund të mbajë pezull procedurën në pritje të vertetimit të një fakti me pasojë plotësimin e një kushti a kriteri kandidimi për një kandidat të caktuar, të tillë si një vendim gjyqësor për heqjen e një mase disiplinore, arritjen e afatit 15-vjeçar të përvojës profesionale, një vendim për dhënien e gradës shkencore në drejtësi, një vendim për dhënien e shtetësisë shqiptare, etj. Kjo do të vendoste kandidatët në procedurë preferenciale, duke cenuar standartin e objektivitetit të Këshillit në vlerësimin e kushteve për kandidatë të caktuar, si dhe do të çenohej parimi i

⁵ Neni 13 i Ligjit 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*.

⁶ Shiko për më shumë Vendimin nr. 49, datë 10.07.2015 i Gjykatës Kushtetuese, e cila, ndër të tjera ka arsyetuar se: *“...omissis...28.Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (shih vendimet nr. 25, datë 11.06.2013; nr. 25, datë 10.06.2011; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)”*.

⁷ Neni 17 i Ligjit 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*.

paanshmërisë së Këshillit. Për rrjedhojë, kandidatët vlerësohen për përmbushjen e kushteve në të njëjtin moment dhe ky moment është pikërisht ai i kandidimit, pra aplikimit për t'u bërë pjesë e procedurës së emërimit. Ky është momenti kur kandidati prezanton veten përpara organit vendimmarrës, në këtë rast Këshillit të Lartë Gjyqësor, përballë konkurentëve të tjerë, si edhe përpara publikut.

21. Në lidhje me këtë Këshilli mban në konsideratë edhe frymën dhe përcaktimet e bëra në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 136, pika 4), sikurse edhe në Ligjin e Statusit, ku sa i përket disa kushteve specifike që duhet të plotësojë kandidati jogjyqtar për në Gjykatën e Lartë, ato që nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit, si moment fundor të këtij afati përcaktojnë atë *“para kandidimit”*, pra deri në momentin e *“kandidimit”*.

22. Po ashtu, Këshilli mban në konsideratë edhe se legjislacioni në fuqi nuk i jep atij, aq më pak organeve pjesë e organizimit të tij, diskrecion për të përcaktuar një moment kohor të ndryshëm kur kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë duhet të vlerësohet për përmbushjen ose jo të kushteve dhe kriterëve të kandidimit, pra diskrecion për të përcaktuar rast pas rasti këtë moment. Përkundrazi, ky moment është vetëm një dhe i njëjtë për të gjithë kandidatët, pikërisht në momentin e kandidimit, sepse vetëm mbi këtë bazë procedura e Këshillit mund të garantojë për të gjithë kandidatët shanse të barabarta, mosdiskriminim, transparencë, objektivitet dhe paanësi. Pikërisht këtë moment Këshilli ka konsideruar për disa kandidatë, në rastin e shqyrtimeve më parë nga ai të plotësimit ose jo nga ata të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit. Në nenin 11 të Kodit të Procedurave Administrative, që rregullon *“Parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit”*, parashikohet se *“Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme: a) është i parashikuar me ligj; b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit; c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme”*.

23. Gjithashtu, Këshilli mban në konsideratë edhe se Komisioni i Venecias, *“Mbi përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për shtetin e Gjeorgjisë”*, në Opinionin nr. 949/2019, 16 prill 2019, ndër të tjera kanë theksuar se: *“25.... Është shumë e rëndësishme që praktikat dhe parashikimet ligjore në lidhje me rekrutimin dhe emërimin e gjyqtarëve të bazohen në merita, të cilat mbështeten në kualifikimin, integritetin, aftësinë, efikasitetin dhe eksperiencën, duke përfshirë aftësitë personale. Gjyqtarët e emëruar në Gjykatën e Lartë duhet të kenë njohuritë ligjore, aftësitë, kompetencën dhe vjetërsinë e kërkuar për të marrë përsipër këtë funksion të rëndësishëm. Për këtë arsye është përcaktuese që procedura e emërimit të mos bazohet në konsiderata politike ose personale. Kriteret e pranueshmërisë duhet të jenë mjaftueshëm të hapura (gjera) me qëllim që të lejojnë diversitetin kandidatësh. 26. Në këtë drejtim-Rekomandimi nr. R (94) 12, i marrë më vonë nga Rekomandimi CM/REC (2010) 12 mbi gjyqtarët: pavarësia, efikasiteti dhe*

përgjegjësitë, edhe nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europiane (CCJE) në Opinionin nr. 1 të tij **vendimmarrjet që kanë lidhje me përzgjedhjen dhe karrierën e gjyqtarëve duhet të bazohen në kriteret objektive që paracaktohet nga ligji ose nga organi kompetent** dhe një vendimmarrje e tillë duhet të bazohet në merita, duke pasur parasysh kualifikimet, aftësitë dhe kapacitetet e kërkuara për të gjykuar çështje duke aplikuar ligjin, e duke respektuar dinjitetin njerëzor⁸. Gjithashtu, **“duhet të ketë një transparencë totale në kushtet e përzgjedhjen së kandidatëve, që gjyqtarët dhe shoqëria vetë të jenë në gjendje të konstatojnë që një emërim është bërë ekskluzivisht në meritat e kandidatit dhe bazohet në kualifikimet, aftësitë, integritetin, sensin e pavarësisë, paanësisë dhe efikasitetin së tij/saj”**⁹. 27. Në lidhje me meritën, Raporti i Komisionit të Venecias mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor, Pjesa I: Pavarësia e gjyqtarëve¹⁰ kërkon që “Merita nuk është vetëm një çështje e njohurive ligjore, aftësive analitike, aftësive komunikuese, efikasitetin për të bërë vendime etj”. Gjithashtu, “Është e rëndësishme që gjyqtari të ketë një sens të së drejtës dhe drejtësisë. Gjithsesi, në praktikë, mund të jetë e vështirë që të vlerësohen këto kriteret. **Procedurat transparente dhe koherente kërkohen që të aplikohen. (...)**¹¹...”.

24. Vlen të evidentohet edhe se i njëjti standard si më lart ndiqet edhe në praktikën italiane, ku Këshilli i Shtetit (Consiglio di Stato¹²), Seksioni III, me Vendimin nr. 965, më 11 mars 2016, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “...duhet pasur në konsideratë se kjo dispozitë përbën një shprehje të një parimi të përgjithshëm, të lidhur rreptësisht me parimet e paanshmërisë së administratës dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve. / Në fakt, në koherencë me parimin favor participationis¹³ në procedurat e përzgjedhjes publike, rregulli i domosdoshmërisë së përmbushjes së kushteve të kandidimit në datën e përfundimit të afatit të paraqitjes së aplikimeve, në vetvete nënkupton transparencë në vendimmarrjen administrative dhe trajtimin e barabartë të atyre që janë kategoria e personave që mund të marrin pjesë në përzgjedhje. / Përcaktimi i një datë tjetër - që nuk përkon me atë të afatit të paraqitjes së aplikimeve - nënkupton në vetvete rrezikun konkret që mund të çojë në përparësi vetëm për disa nga kandidatët pjesëmarrës, duke përjashtuar të tjerët dhe, për rrjedhojë, pabarazi të pajustificuara të trajtimit. / Ky Seksion mban parasysh se parimi i maturimit të kushteve të kandidimit në përfundim të afatit të paraqitjes së kërkesës - përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga një dispozitë normative - mund të ketë përjashtim vetëm nëse ka arsye specifike dhe të provuara të interesit publik, për shembull kur është për të dhënë një ekzekutim të arsyeshëm të vendimeve gjyqësore ose nëse ka nevojë për të respektuar një suksesim kronologjik midis procedimeve të lidhura, ose për të mbrojtur pozicionet e fituara në mënyrë të ligjshme nga subjektet e interesuar në konkurset e brendshme...”.

⁸ Rekomandimi CM/ Rec (2010) 12, paragrafi 44.

⁹ Shiko Opinionin e CCJE nr. 10 (2007) mbi Këshillin e Gjyqtarëve në shërbim të shoqërisë, paragrafi 50.

¹⁰ CDL-AD (2010) 004, Raporti mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor Pjesa I: Pavarësia e gjyqësorit.

¹¹ CDL-AD (2010) 004, paragrafi 25.

¹² Këshilli i Shtetit (Consiglio di Stato) është organ kushtetues në shtetin italian. Ai është organ gjyqësor dhe vepron si gjykatë e posaçme administrative.

¹³ Parimi favor participationis nënkupton që interpretimi i rregullave duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të favorizojë sa më shumë numrin e pjesëmarrësve.

25. Mbi sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidatja znj. nuk plotëson kushtin e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, atë të *“nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”*, përcaktuar, sipas autorizimit të dhënë nga Kushtetuta (neni 136, pika 4, fjalia e dytë), në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidates nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë ku ajo ka konkuruar.

V. KONKLUZIONE

1. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidatja znj. {...} nuk plotëson një prej kriterëve të kandidimit për në Gjykatën e Lartë, atë të *“nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi”*, përcaktuar në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidates nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë ku ajo ka konkuruar.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret nuk është i nevojshëm shqyrtimi i rezultateve të verifikimit në lidhje me plotësimin ose jo nga kandidatja të kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, pikërisht të pasurisë dhe të figurës, përsa kohë, sipas ligjit, mosplotësimi edhe i një kushti ose kriteri të vetëm kandidimi passjell skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 136, pika 4 dhe në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 49, pika 2, shkronja “a” në lidhje me nenin 28, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “c”, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “e”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor

VENDOSI:

1. Skualifikimin e kandidates jogjyqtare znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga kandidimi për emërim si gjyqtare në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019 dhe Vendimin nr. 110, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidatja ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR